



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivery	05-10-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSJK	5905/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 783/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 783/2022 të datës 08.09.2022 të parashtruar nga ankuesja me avokat me adresë banimi kundër organit të punësimit Komuna e Shtimes, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.10.2022, mori këtë;

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr. 783/2022 të datës 08.09.2022 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 08.09.2022, me numër protokolli 5219/2022, ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, kundër njoftimit me numër 02/1-112 të datës 15.08.2022, të Komisionit të Pranimit të Komunës së Shtimes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Shtimes Ndërsa Këshilli me datë 20.09.2022,ka pranua nga Komuna e Shtimes, përgjigjen në kërkesë me numër protokolli: 4541/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 783/2022 të datës 08.09.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 05.09.2022; Vërtetimi i datës 01.06.2019; Vendimi me numër 02/1-112 i datës 15.08.2022, i Komisionit të Pranimi; Vërtetim i datës 06.02.2016; Vërtetim i datës 15.06.2022; Letër reference e datës 20.06.2022; e-mailit i datës 16.08.2022; njoftimi i datës 15.08.2022; Konkursi i datës 14.06..2022; Rezultatet e vlerësimit të datës 09.08.2022; Pyetje për vlerësimin me gojë për pozitën „ Zyrtar për Shërbime Sociale 2’; Formulari për vlerësimin individual të Jetëshkrimit; Vendimi i datës 06.07.2022, për formimin e Komisionit për pranim; Njoftimi i datës 01.07.2022; Njoftimi i datës 05.07.2022; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 13.07.2015; Marrëveshje për angazhim e datës 04.02.2020; Vendim i datës 08.10.2009; Marrëveshje për angazhim e datës 05.02.2020; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitur; Diplomë e datës 17.11.2017; reference e datës 09.06.2022; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 01.05.2016; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; Vërtetim i datës 30.03.2022; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; certifikatë e datës 03.07.2017; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; Certifikatë e datës 30.09.2011; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 10.07.2017; Diplomë e datës 01.07.2017; Vërtetim i datës 03.03.2016; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 26..01.2022; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 21.04.2015; Certifikatë e datës 02.06.2021; Kontrata e punës 01.06.2020; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 21.07.2012; Vërtetim i datës 08.09.2020; Vërtetim i datës 07.07.2020; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 19.11.2018; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 05.05.2021; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 24.11.2012; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 20.05.2016; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 08.09.2021; diplomë e datës 05.07.2019; Vërtetim i datës 30.06.202; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 20.10.2020; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 11.09.2010; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; referencë e datës 31.05.2022; Vërtetim i datës 10.07.2010; diplomë e datës 25.11.2009; diplomë e datës 30.08.2020; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 01.07.2017; referencë e datës 18.04.2019; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 13.07.2006; Vërtetim i datës 11.02.2010; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; shkresë emërim e datës 01.04.2011; vërtetim i datës 24.03.2022; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 27.06.2013; Vërtetim i datës 20.06.2022; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 01.07.2021; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 15.10.2019; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 16.01.2017; diplomë e datës 18.11.2011; Vërtetim i datës 18.02.2017; marrëveshje për angazhim e datës 01.03.2019; Vërtetim i datës 29.03.2018; Kontratë e punës e datës 30.03.2017; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; Aplikacioni për me shkresat e bashkangjitura; certifikatë e datës 29.07.2013; diplomë e datës 15.05.2015; Aplikacioni për me

shkresat e bashkangjitura; Vendimi i datës 15.09.2022, A. Nr. 684/2022, i Këshillit; Përgjigje në ankesës e datës 20.09.2022, me numër protokolli 5507/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses është bërë i pamundur *sepse*:

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka pranuar ankesën nga ankuesja e cila ka kërkuar që të anulohet në tersi konkursin për pozitën "Zyrtar për Shërbime Sociale" të publikuara nga Komuna e Shtimes. Lidhur me këtë proces, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar ankesë edhe nga një kandidat tjetër në këtë procedurë dhe sipas shqyrtimit të ankesës më datë 15.09.2022 ka nxjerr Vendim A.nr. 684/2022 përmes të cilët ka aprovuar të njëjtën duke e anuluar në tersi procedurën për grup të pozitave Specialit të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale" respektivisht për pozitën "Zyrtar për Shërbime Sociale".

Bazuar në këto rrethana Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse konkursi i lartcekur është anuluar atëherë edhe pretendimet ankimore të ankueses janë përmbushur, rrjedhimisht edhe objekti për të cilin kishte filluar procedimi administrativ më ankesën e datës 08.09.2022 të ankueses është bërë i pamundur, rrjedhimisht, në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*", Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative të filluar me ankesën A.nr. 783/2022 të datës 08.09.2022 të parashtruar nga ankuesja.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 783/2022

Rushit KAJTAZI

Proçesmbajtës

Esref SHABANI

Kryetari i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- *Përfaqësuesit të ankueses Avokat*
- *Kryetarit të Komunës së Shtimes;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Shtimes;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

